

PROMOVIME LIBRASH NË PRISHTINË

për disa botime të Institutit të Historisë, të Fakultetit Histori-Filologji dhe AQSH të viteve 2006-2007

Më datë 7 dhjetor 2007, në Prishtinë, në sallën e hotel “Grant”, Instituti i Historisë-Tiranë, Fakulteti Histori-Filologji i UT-së dhe AQSH, nën kujdesin dhe në bashkëpunim me Institutin e Historisë-Prishtinë organizuan prezantimin e disa botimeve të realizuara gjatë dy viteve të fundit 2006-2007 nga studiuesit e institucioneve përkatëse në rrugë institucionale ose jashtëinstitucionale. Në fjalën e rastit, drejtori i Institutit të Historisë-Prishtinë, Prof. dr. Jusuf Bajraktari, drejtori i Institutit të Historisë-Tiranë, Prof. dr. Marenglen Verli dhe drejtoresha e AQSH, Prof. dr. Nevila Nika, theksuan se “tubimi i këtij karakteri ishte një formë e re bashkëpunimi për paraqitjen reciproke të veprave të botuara në të dy kryeqytetet, i cili zhvillohej në frymën shumëvjeçare të forcimit të bashkëpunimit dhe të realizimit të projekteve të përbashkëta studimore, botuese, publikjuese etj.”. Veprimtaria u ndoq me interes nga studiues të fushave të ndryshme të albanologjisë dhe u pasqyrua gjerësisht nga media e shkruar dhe elektronike e Kosovës.

Librat e prezantuar

1. *Historia e Popullit Shqiptar (1912-1939)*, Vëllimi III, Botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë 2007 (Redaktorë prof.dr. Kristaq Prifti, prof.dr. Gazmend Shpuza).
2. *Skënderbeu dhe Evropa (Përmbledhje kumtesash)*, Tiranë 2006 (Botim i Institutit të Historisë, redaktor prof.dr. Ferit Duka).
3. Theofan Popa, *Miniatura dhe piktura mesjetare në Shqipëri (shek. VI-XIV)*, Tiranë 2006 (Botim në bashkëpunim i Institutit të Historisë me Arkivin Qendror Shtetëror).
4. Prof. dr. Beqir Meta, *Tensionet greko-shqiptare (1939-1949)*, Tiranë 2006 (Instituti i Historisë). Botuar edhe në gjuhën angleze.
5. Prof. dr. Beqir Meta, *Shqipëria dhe Greqia 1949-1990. Paqja e vështirë*, Tiranë 2007 (Instituti i Historisë). Botuar edhe në gjuhën angleze.

6. Dr. Dritan Egro, *Historia dhe ideologjia, një qasje kritike e historiografisë*, Tiranë 2007 (Instituti i Historisë).
7. Prof. dr. Marenglen Verli, *Nga Kosova për Kosovën (Profile bibliografike)*, Vëllimi I, Tiranë 2006 (Instituti i Historisë).
8. Prof. dr. Marenglen Verli, *Kosova, sfida shqiptare në historinë e një shekulli (Studime dhe dokumente)*, Tiranë 2007 (Instituti i Historisë).
9. Prof. dr. Marenglen Verli, *Shqipëria dhe Kosova, historia e një aspirate (Studime dhe dokumente)*, Vëllimi I, II, Tiranë 2007 (Instituti i Historisë).
10. Prof. dr. Muin Çami, *Shqipëria në rrjedhat e historisë (1912-1924), (Pëmbledhje studimesh)*, Tiranë 2007 (Instituti i Historisë).
11. Prof. as. Dr. Hamit Kaba, *Shqipëria në rrjedhën e Luftës së Ftohtë (Studime dhe dokumente)*, Tiranë 2007 (Instituti i Historisë).
12. Prof. dr. Gazmend Shpuza, *Pages d'histoire albanaise (1474-1934) (Studime)*, Istanbul 2006.
13. Prof. Petraq Pepo, Mihallaq Pela, *Kanunore të shoqërive shqiptare (1870-1936)*, Vëll.I, Tiranë 2007 (Botim në bashkëpunim i Arkivit Qendror Shtetëror me Institutin e Historisë).
14. Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-2000*, Universiteti i Tiranës, Fakulteti Histori-Filologji, Tiranë 2007.
15. Prof. dr. Muhamet Shatri, Prof. dr. Ramiz Abdylly, *Dokumente ruse për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare më 1912*, Prishtinë 2007 (Botim në bashkëpunim i Institutit të Historisë - Prishtinë me Institutin e Historisë - Tiranë).
16. Prof. dr. Nevila Nika, *Përmbledhje dokumentesh mbi kryengritjen shqiptare (1910-1912)*. (Botim i Arkivit Qendror të Shtetit në bashkëpunim me Institutin e Historisë, Prishtinë).
17. Prof. dr. Nevila Nika, Liliana Vokshi, *Udhërrëfyes arkivor për hebrenjtë në Shqipëri*, Tiranë 2006 (Arkivi Qendror Shtetëror).
18. Prof. dr. Fatmira Rama, *Dukuri arsimore gjatë Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri*, Tiranë 2006 (Universiteti i Tiranës, Fakulteti Histori-Filologji).
19. Revista *Studime historike*, nr. 1-2, nr. 3-4, Tiranë 2006 (Instituti i Historisë).
20. Lef Nosi, *Dokumente për historinë e Shqipërisë*, Tiranë 2007 (Instituti i Historisë, redaktorë prof.dr. Marenglen Verli, prof.dr. Ferit Duka).

21. *Pavarësia e Shqipërisë dhe sfidat e shtetit shqiptar gjatë shek. XX*, Tiranë 2007 (Në bashkëpunim Instituti i Historisë me Universitetin e Tiranës, redaktor prof.dr. Marenglen Verli).
22. Revista *Studime historike*, nr. 1-2, Tiranë 2007 (Instituti i Historisë, kryeredaktor prof.dr. Marenglen Verli).

Marenglen VERLI



Foto nga veprimtaria në Prishtinë për promovimin e botimeve